

FORMULAR PËR SYLLABUS TË LËNDËS: SELEKSIONIMI

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Seleksionimi
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhje
Viti i studimeve:	I're
Numri i orëve në javë:	2+2/javë
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Prishtine
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Hysen Bytyqi. Asoc. Prof Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë Departamenti i Zooteknisë në Zootechni.
Detajet kontaktuese:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë Zyra Nr. 26
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Përmbajtjen e kursit: Ky kurs është i dizajnuar për të arritur njohurit mbi parimet themelore të seleksionimit të kafshëve. Pjesa e parë e kursit do të shqyrtojë konceptet klasike (Mendelian) trashëgimore dhe gjenetikën populacioneve. Studentet do të mësojnë se si të llogarisin dhe interpretojnë fenomenet e përdorura statistikore për të përshkruar vlerën gjenetike të kafsheve. Pastaj, do të diskutohen parimet për përzgjedhjen (seleksionimin) afat-shkurtër dhe afat-gjatë për përmirësim ferme. Fokus i veçantë do i kushtohet interpretimit të vlerave gjenetike, duke përfshirë informacionin të lidhura me kryqezimet, pasojat e inbridng'ut, outbridng'u, faktoret e seleksionimit natyral dhe artificial, faktoret gjenetik me ndikim në seleksionimin e kafsheve, etj. Kursi do të përfundojë me një paraqitje të teknologjive të reja për përmirësimin gjenetik të blegtorisë dhe ruajtjen e ndryshueshmërisë gjenetike.</p>
Qëllimet e lëndës:	Lënda "Seleksionimi" ka për qëllim ngritjen e njohurive të studenteve lidhur me: Sistemet e seleksionimit dhe kryqëzimit ndërmjet racave të ndryshme të kafshëve; programet për vlerësim gjenetik; vlerësimin e programeve për mirësimin gjenetik, zbatimin e programeve të mbarështimit të kafshëve; vlerësimin dhe karakterizimin e racave autoktone të bagëtive të ndryshme; etj.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të jenë në gjendje të: - Përdor interpretimet statistikore për të përshkruar ndryshimet gjenetike dhe fenotipore të popullatave të kafshëve.

	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegoj përdorimin e informacionit fenotipor të kafshëve dhe të afërmeve të tyre duke llogaritur aftësinë përcjellëse për veçoritë e ndryshme. - Kupton konceptet themelore të: indeksit të përzgjedhjes, heritabilitetit, repitabilitetit, korrelacionit, regresionit, saktësisë, intensitet të përzgjedhjes (seleksionimit), intervali të gjeneratës dhe efektet e tyre në ndryshimet gjenetike. - Parimi i Hardy-Weinberg dhe forcat që shkakton ndryshime gjenetike dhe frekuencat e gjenotipeve. - Kuptojnë rolin e gjenetikës molekulare dhe teknologjive të reja në seleksionimin dhe përmirësim gjenetik.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/	Javë	Gjithsej:
Ligjërata	2	30	30	30
Ushtrime (pune praktike, seminare, ushtrime, etj)	2	30	30	30
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	0.5	15	15	7.5
Detyra të shtëpisë	0.5	10	10	5
Projekte, rasti sdu timor , prezantime..etj.	2	30	30	30
Koha e studimit vetanak	3	45	45	45
Përgatitja përfundimtare për provim	0.5	2	2	1
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuize, provim final)	0.5	3	3	1.5
Totali	11	165	165	150

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjërata, ushtrime, qasje interaktive, konsultime, punim seminari, punë në grupe, etj.</p> <p>Ligjërata (30%)</p> <p>Puna praktike (pune fushore, pune laboratorike) (30%)</p> <p>Pune individuale dhe prezantim nga studentet (20%)</p> <p>Udhëzues tjerë (10%)</p> <p>Vlerësimi (10%)</p>
-------------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i parë: 20%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 20%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%</p> <p>Vijimi i rregullt 10%</p> <p>Provimi final 40%</p> <p>Total 100%</p>
------------------------------	---

Literatura

Literatura bazë:	Richard M. Bourdon. 1997. Understand Animal Breeding (2nd edition). SF105. B67. http://www.amazon.com/Understanding-Animal-Breeding-Richard-Bourdon/dp/0130964492 Lynch, M. and B. Walsh. 1998. Genetics and Analysis of Quantitative Traits. Sinauer.
Literatura shtesë:	Materialet e ligjëratave dhe ushtrimeve (Skriptat) të përgatitura nga arsimtari i lendes (Hysen Bytyqi) të cilat do tu dozohen studenteve në fund të çdo ligjërate. Artikuj shkencor të mësimdhënësit të lëndës të cilët mund të gjenden në faqet e revistave shkencore Internet).
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
Java e parë:	Parimet themelore të përzgjedhjes (Seleksionimit). Historia e Kafshëve. Seleksionimi i kafshëve dhe përmirësimi Gjenetikë
Java e dytë:	Rishikimi i parimeve themelore të trashëgimisë Mendeliane. Aspektet gjenetike qelizore
Java e tretë:	Trashëgimia e veçorive cilësore Abnormalitetet gjenetike
Java e katërt:	Gjenetika e popullacionit Gjeni, veçoritë, gjenotipi, fenotipi dhe frekuenca e gjeneve. Parimi i Hardy-Weinberg'ut
Java e pestë:	Gjenetika e popullacionit Forcat që ndikojnë në ndryshimin e frekuencave të gjeneve a) Mutacion b) Migrimi c) Përzgjedhja (Seleksionimi) d) Drifti gjenetikë
Java e gjashtë:	Variacionet gjenetike dhe fenotipore Fenomenet statistikore për shpjegimin e vlerave mbarështuese të kafshëve a) Mesataret b) Devijimi dhe gabimi standard c) Regresioni dhe korrelacioni
Java e shtatë:	Variacionet gjenetike dhe fenotipore a) Trashëgimi i tipareve sasiore b) Trashëgimia dhe mjedisi
Java e tetë:	Parimet themelore të përzgjedhjes (Seleksionimit) a) Përzgjedhja në popullacion b) Heritabiliteti dhe repitabiliteti c) Diferenciali i përzgjedhjes
Java e nëntë:	Parimet themelore të përzgjedhjes (Seleksionimit) a) Intervali i gjeneratës

	b) Korrelacioni gjenetik
Java e dhjetë:	Metodat e përzgjedhjes së tipareve poligjenike.
Java e njëmbëdhjetë:	Sistemi i çiftëzimit të kafshëve: Çiftëzimi në farefisni (Inbreeding'u) a) Niveli i marrëdhënies së çiftëzimit në farefisni (inbreeding'ut) b) Efektet e çiftëzimit në farefisni (inbreeding'ut) c) Çiftëzimi në linjë (Linebreeding'u)
Java e dymbëdhjetë:	Çiftëzimi jashtë farefisnie (Outbreeding'u) a) Heterozat Sistemet e kryqëzimit ndërmjet racave të ndryshme ka fshëve (crossbreeding'u)
Java e trembëdhjetë:	Programet për vlerësim gjenetik. Hyrje në ecurinë e programeve për vlerësimin gjenetik a) Rregullimi i të dhënave b) Testimi i efektit të fermës, individit, etj.
Java e katërbëdhjetë:	Ndikimi i Mbarësimit Artificial (MA) në përmirësim gjenetik të kafshëve. Ndikimi i Embrio-transferit (ET) në përmirësim gjenetik të kafshëve
Java e pesëmbëdhjetë:	Teknologjitë moderne për të kuptuarit e mbarështimit të Kafshëve. Kontrolli i gjinisë (sex'it) Njohurit themelore mbi rekombinimet dhe klonimi i ADN's

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja e studenteve e ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Reflektimi në punë në grupe është i dëshirueshëm.